

**UDHËZIM**  
**Nr. 26, datë 18.8.2015**

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT  
NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA  
MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA, NË  
CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE NË  
PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK  
2015-2016**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015 – 2016”, si dhe në zbatim të vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”, si dhe vendimit nr. 241, datë 31.3.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kryerjen nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike”,

**UDHËZOJ:**

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të aplikojnë direkt pranë institucioneve publike të arsimit të lartë (IAL), nga data 24 gusht 2015 deri më datë 7 shtator 2015 sipas kuotave të përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave.

2. Kandidatët që konkurrojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimi, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri në datën 21 gusht 2015, sipas procedurave të udhëzimit nr. 24 datë 31.7.2015, të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit.

Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet, si dhe dokumentin e njohjes në Republikën e Shqipërisë nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të arsimit të mesëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) Dy fotografi;

d) Autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi;

e) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekë paguar pranë zyrave të Postës Shqiptare, për llogari të IAL-së publike përkatëse.

4. IAL-të, brenda datës 8 shtator 2015, të përcjellin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) listën e kandidatëve të cilët përmbushin kriteret e pranimi, kopje të dokumentacionit të përcaktuar në ghermat “a”, “b” dhe “d” të pikës 3 të këtij udhëzimi, si dhe një shkresë shoqëruese ku deklarohen kriteret e pranimi të aplikuar, si dhe aktin e miratimit të tyre (rregullore, statut). Në rastet kur numri

i kandidatëve për një program të caktuar studimi është me i vogël ose i barabartë me numrin e kuotave të miratuara për këtë program studimi, IAL përcjell për miratim në MAS listën e kandidatëve.

5. Në rastet kur numri i kandidateve për një program të caktuar studimi është më i lartë se numri i kuotave të miratuara për këtë program studimi, përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Komisioni, në përzgjedhjen e kandidatëve, bazohet në notën mesatare të shkollës së mesme dhe notat e lëndëve për të cilat IAL-të publike kanë vendosur koeficientët më të lartë për pranimet në këtë vit akademik, për programin përkatës të studimit. Nëse, edhe duke u bazuar në këto kritere, do të rezultojnë kandidatë me pikë të barabarta, ato do t'i nënshtrohen testimit që do të kryhet nga MAS.

6. Brenda datës 22 shtator 2015 MAS përcjell në IAL-të respektive listën e kandidatëve të përzgjedhur sipas procedurës së mësipërme, si dhe listën, e miratuar nga MAS, të kandidatëve të përcjellë nga IAL-të, në zbatim të pikës 5 të këtij udhëzimi, për të vijuar me regjistrimin e kandidateve në programet përkatëse të studimit. MAS publikon në faqen weblistën e kandidateve dhe afatet e regjistrimit të tyre në IAL-të përkatëse.

7. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në periudhën 23 shtator deri në 1 tetor 2015. IAL-të, brenda datës 2 tetor 2015, përcjellin listat emërore të kandidatëve të regjistruar, në MAS dhe AKP (për gjenerimin e numrit të matrikullimit), në formë shkresore dhe elektronike, sipas formatit të dërguar nga AKP, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikulimit", të ndryshuar.

8. Në përfundim të procedurave të seleksi-onimit, MAS vlerëson mundësinë e rishpërndarjes së kuotave të mbetura bosh. Mund të përfitojnë nga kuotat e rishpërndara kandidatët të cilët kanë aplikuar pranë IAL-ve brenda datës 7 shtator 2015 dhe nuk kanë rezultuar fitues në raundin e parë të shpërndarjes së kuotave.

9. MAS procedon me përcaktimin e emrave të kandidateve në programet ku janë rishpërndarë kuotat dhe brenda datës 6 tetor 2015 i përcjell IAL-ve respektive listat e kandidatëve fitues. MAS publikon në faqen weblistën e kandidatëve dhe afatet e regjistrimit të tyre në IAL-të përkatëse.

10. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në periudhën nga data 7 tetor 2015 deri më 12 tetor 2015, duke paraqitur dokumentet përkatëse, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi. IAL-të brenda datës 16 tetor 2015 përcjellin listat emërore të kandidatëve të regjistruar, në MAS dhe AKP, për gjenerimin e numrit të matrikullimit, në formë shkresore dhe elektronike, sipas formatit të dërguar në AKP, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikulimit", të ndryshuar.

11. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve(AKP) dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Lindita Nikolla**

Shtojca nr. 1

Tiranë, më

\_\_\_\_/\_\_\_\_/2015

### AUTORIZIM

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ autorizoj institucionin e arsimit të lartë \_\_\_\_\_ dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të pranimin në programin e studimit të ciklit të parë/ të integruar të ciklit të dytë \_\_\_\_\_ ofruar nga institucioni i arsimit të lartë i sipërcituar, si dhe publikimin eventuale të tyre.

Emër, atësi, mbiemër

Firma